

Emri i Lëndës : International Private Law

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 324	N/A	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori							
Erisa Datja, MSc							
Asistenti							
Gjuha e kursit							
Shqip							
Niveli i lëndës							
Bachelor							
Përshkrimi							
Lënda "E Drejtë Ndërkombëtare Private" u jep studentëve njohuri lidhur me raste specifike kur marrëdhëniet juridiko-civile karakterizohen nga ekzistenza e një elementi të huaj, cka ndikon në mënyrën sesi do trajtohet cështja nga gjykatat. Gjatë këtij kursi, studentët do janë të aftë të identifikojnë dhe t'u jasin zgjidhje rasteve kur kemi konflikte mes ligjeve të shteteve të ndryshme duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për të drejtën ndërkombëtare private si dhe në burime të tjera. Gjithashtu, do të trajtohen edhe bazat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe të marrëveshjeve të arbitrazhit, me anë të qasjes praktike duke evidentuar avantazhet dhe disavantazhet e arbitrazhit dhe cështje të tjera të lidhura me to.							
Objektivat							
Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të janë të aftë të njohin të Drejtën Ndërkombëtare Private në përgjithësi, cështjet e lidhura me juridiksonin e gjykatës shiptare, ligjin e zbatueshëm, zgjedhjen e ligjit për cështje të ndryshme lidhur me familjen, pronësinë, detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore dhe arbitrazhin.							
Konceptet Kryesore							
1. Normat e konfliktit 2. Elementi i huaj 3. Ligji i zbatueshëm 4. Klauzola e rendit publik 5. Arbitrazhi ndërkombëtar							

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Hyrje e përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare private/ Vështrim historik në të drejtën ndërkombëtare private Njohuri të përgjithshme mbi të drejtën ndërkombëtare private duke shpjeguar disa nga konceptet më të rëndësishme të lëndës si dhe duke analizuar zhvillimin historik të saj dhe fushën e veprimit. Gjithashtu, shqyrtohet raporti që ka e drejta ndërkombëtare private me degët e tjera të së drejtës së drejta ndërkombëtare publike, e drejta kushtetuese dhe e drejta civile përfshirë e drejta familjare, e drejta e detyrimeve, e drejta tregtare etj.. (Fq. 13-40)
2	Burimet e së drejtës ndërkombëtare private Shpjegimi i burimeve të së drejtës ndërkombëtare private duke përfshirë burimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Tema trajton mënyrën sesi burimet ndërkombëtare bëhen pjesë e sistemit ligjor të brendshëm duke patur parasysh procedurën e parashikuar në Kushtetutë. (Fq. 41-58)
3	Marrëdhëniet juridike ndërkombëtare private Kjo temë trajton marrëdhënien juridike ndërkombëtare private duke përcaktuar se cilat janë subjektit e kësaj marrëdhënie dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre. Leksioni ndalet vecanërisht tek shteti si një subjekt i vecantë i marrëdhëniejës juridike. Gjithashtu, analizohen personat fizikë në cilësinë e shtetasve shqiptarë dhe të huaj dhe personat juridike duke përmendur pozitën juridike të tyre. (Fq. 59- 94)
4	Normat e konfliktit, ndërtimi dhe vecoritë e saj Kjo temë jep kuptimin e normës së konfliktit, funksionin dhe karakteristikat e saj. Gjithashtu, ky leksion analizon elementët përbërës të normës së konfliktit që janë tregimi i fakteve dhe kriteri i lidhjes. (Fq. 95-118)
5	Aplikimi dhe efektet e normave të konfliktit Tema përqëndrohet tek aplikimi i normave të konfliktit duke patur parasysh kriteret e lidhjes që ekzistojnë në marrëdhënien juridike me elementë të huaj. Ndër objektivat e kësaj jave janë edhe dhënia e kuptimeve dhe pasqyrimi me shembuj i nocioneve si klauzola e rendit publik, parimi i reciprocitetit dhe mënyrat e referimit tek ligji i huaj. (Fq. 119-136)

6	E drejta familjare në të drejtën ndërkombejtare private I (Martesa) Kjo temë ka pqr qëllim të identifikojë ligjin e zbatueshëm pér marrëdhëniet familjare që kanë në brendësi elementë të huaj. Pra, përcaktohet cili është ligji i zbatueshëm pér formën e martesës, kushtet e martesës, marrëdhëniet personale dhe pasurore të bashkëshortëve si dhe pavlefshmërinë dhe zgjidhjen e martesës. (Fq.187-213)
7	E drejta familjare në të drejtën ndërkombejtare private (Përgjegjësia prindërore, birësimi, kujdestaria) Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm pér marrëdhëniet familjare me elemëtë të huajlidhur me përgjegjësinë prindërore, detyrimin pér ushqim, birësimin dhe kujdestarinë. (Fq. 214-222)
8	Provimi gjysmë-final
9	Pronësia në të drejtën ndërkombejtare private Kjo temë përcakton ligjin e zbatueshëm pér cështje të lidhura me pronësinë si mënyrat e fitimit të pronësisë, posedimin, pronësinë mbi sendet dhe të drejtat mbi të mirat jomateriale. (Fq.149-166)
10	Trashëgimia në të drejtën ndërkombejtare private Kjo cështje trajton zhvillimin historik të trashëgimisë në të drejtën ndërkombejtare private duke shqyrtaur problemet kryesore të lidhura me trashëgiminë ligjore dhe testamentare dhe duke përcaktuar ligjin që do të zbatohet lidhur me to. (Fq. 167- 186)
11	Detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore në të drejtën ndërkombejtare private Fillimisht, tema paraqet një panoramë historike krahasuese të ndeshjes së legjisacioneve të ndryshme në të drejtën e detyrimeve dhe më pas identifikon ligjin e zbatueshëm pér disa nga kontratat më të rëndësishme të qarkullimit civil. (Fq. 223-288)
12	Juridiksoni i gjykatave shqiptare në shqyrtimin e cështjeve me elemente të huaja Mbështetur në dispozitat e ligjit pér të drejtën ndërkombejtare private, ky leksion ka pér qëllim të përcaktojë juridiksonin e gjykatave shqiptare në shqyrtimin e cështjeve me elemente të huaja duke u ndalur vecanërisht në kuptimin e juridiksonit ndërkombejtari, juridiksonit ekskluziv dhe atij të caktuar me marrëveshje. (Ligji pér të Drejtën Ndërkombejtare Private, nenet 71-81)
13	Arbitrazhi ndërkombejtari Si një nga institutet më të rëndësishme në marrëdhëniet juridike me elementë të huaj, ky leksion synon t'u japë njohuri studentëve mbi zhvillimin historik të arbitrazhit ndërkombejtari duke përmëndur funksionin dhe rolin e madh që ka pér zgjidhjen e konflikteve që kanë në brendësi elementin e huaj. (Fq. 327- 366)
14	Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të huaja Kjo temë trajton procedurën sesi bëhet njohja e vendimeve gjyqësore të huaja nga gjykatat shqiptare dhe si bëhet zbatimi i tyre. Gjithashtu ndalet në doktrinën juridike që trajton disa lloje të njohjes së vendimeve gjyqësore të huaja. (Fq. 367-395)
15	Përsëritje
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> Ardian Kalia, E drejta ndërkombejtare private (Tiranë: 2008) Daniel Gutmann, E drejta ndërkombejtare private (Tiranë: Papirus 2015)
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> Ligji nr.10 428, datë 2.6.2011 "Për të drejtën ndërkombejtare private" Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë Kodi i Familjes Legjislacioni mbi Birësimet

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Pas përfundimit të lëndës, përsa i përket procesit gjyqësor, studenti do të jetë në gjendje të vlerësojë rëndësinë e identifikimit paraprak të hapësirës së mundshme për proces gjyqësor dhe të përcaktojë gjykatën e duhur për zgjidhjen e konflikteve në çështje familjare, kontraktore apo jashtëkontraktore.
2	Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë i aftë të kuptojë natyrën e procesit të zgjedhjes së ligjit dhe të përcaktojë ligjin e zbatueshëm për kontratat si dhe të jetë i aftë të vlerësojë procedurën për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave të huaja.
3	Përsa i përket pjesës së lëndës që ka të bëjë më arbitrazhin, studenti do të jetë i aftë të kuptojë avantazhet dhe disavantazhet e arbitrazhit si një nga format e zgjedhjeve alternative të konflikteve civile gjyqësore, të hartojë marrëveshje arbitrazhi, të zgjedhë arbitrazhin institucional ose ad hoc, të kuptojë rolin e gjykatave vendase në procedurat e arbitrazhit dhe të kuptojë mekanizmin e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	50
Kuize	0	0
Projekte	0	0
Projekte semestrale	0	0
Punë laboratori	0	0
Pjesëmarrja në mësim	0	0
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final	50	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final	50	
Total	100	

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	3	3
Provimi final	1	4	4
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00